

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"AUTO ÇOKU" SHPK

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"AUTO ÇOKU" SHPK**, eshte themeluar nga ortakut i vetem Z. **Erlind Çoku**, atesia Emin, i datelindjes 17.03.1989, banues ne Elbasan , i identifikuar me leternjoftimin me nr.personal I90317076B, madhor, me zotesi te plote per te vepruar; ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise nr. 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per QKB", te ndryshuar.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Shoqeria eshte person juridik i se drejtes shqiptare dhe gezon te drejatat e personit juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Bizneseve. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e aktit te themelimit e te ketij statuti.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 2

Import-eksport,tregtim i automjeteve dhe dhenie me qera e tyre.

SELIA E SHOQERISE

Neni 3

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"AUTO ÇOKU" SHPK**, ka seline e saj ne Z.k 2346, nr.pasurie 436/2/8 , Kusarth ,Elbasan . Shoqeria mund te kryeje e te transferoje, apo te suprimoje qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit.

KOHEZGJATJA

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete pa afat, me mundesine e zgjatjes apo te shkurtimit te afateve, te ndryshoje veprimtarine, emertimin, seline, objektin e veprimtarise sipas vendimit te ortakut te shoqerise.

DETYRIMET E ORTAKUT

Neni 5

Ortakut i vetem i shoqerise duhet te kryeje depozitimin e kapitalit themeltar per llogari te shoqerise ne nje banke te caktuar prej tij.

TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6

Ortakut i vetem mund te kaloje pjesen nga kapitali themeltar i personave te tjere ne perputhje me rregullat e parashikuara ne nenin 73 te ligjit 9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

PARAQITJA KONTABILE

Neni 7

Operacionet e shoqerise kontabilizohen duke aplikuar parimet e kontabilitetit te parashikuara ne legjislacionin shqiptar dhe paraqitjen me saktesi ne bilancin vjetor te aktivitetit.

Ne mbyllje te cdo viti ortaku i vetem ose personi i ngarkuar prej tij, ben inventarizimin dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin dhe harton raport me shkrim. Ky raport pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit financiar.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 (njqind mije) leke. Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tij si vijon :

Lloji i kontributit eshte ne para ne vleren 100 000 (njqind mije) leke, i ndare ne 1 kuot ne vleren 100 000(njqind mije) leke, e cila perben 100% vleren e kapitali themeltar.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte shlyer dhe nenshkruar teresisht nga ortaku i shoqerise.

OPERACIONET FINANCIARE

Neni 9

Shoqeria eshte e autorizuar per te siguruar mjete financiare dhe kredit duke ju drejtuar bankave, institucioneve te kreditit ose atyre te financimeve totale apo te jashtme, institucioneve nderkombetare te financimit dhe te kreditit sido qe te jete percaktuar.

BLERJET E SHOQERIVE

Neni 10

Shoqeria disponon mjetet e saj ne perputhje me destinacionin e tyre dhe me objektin e shoqerise. Ne Republiken e Shqiperise, shoqeria gezon te drejten e saj per te zoteruar mjete te saj si ne cdo shoqeri tjeter ose organizate tregtare, kombetare shqiptare ne perputhje me Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

FONDI REZERVE

Neni 11

Shoqeria mund te themeloje nje fond rezerve si dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin e tij.

Perberja, shuma totale, fondet per krijimin e tyre perdorimi dhe rregullimi i tyre (i cdo fondi) percaktohet nga ortaku i vetem ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale te shoqerise raportohen ne balance te shprehur ne leke shqiptare, ne perputhje me rregullat ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Bilanci dhe perllogaritjet ekonomike te shoqerise hartohen mbi bazen e formes se bilancit dhe llogaritjeve ekonomike te percaktuara per shoqerite tregtare ne Shqiperi. Bilanci vjetor mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.

PLANET FINANCIARE

Neni 12

Aktiviteti i shoqerise mbi bazen e programeve financiare qe bejne pjese ne aktivitetin financiar te saj. Planet financiare parashikojne koston dhe te ardhurat e shprehura ne leke shiptare. Gjendja pasurore dhe llogaritjet ekonomike do te paraqiten ne leke shqiptare. Rezultatet financiare te aktivitetit dhe te punes se kryer nga shoqeria, paraqiten ne bilancin vjetor. Kursi i kembimit te monedhes shqiptare ne monedhat e huaja dhe e kunderta do te jene ato te vendosura nga Banka e Shtetit Shqiptar.

ORGANET E SHOQERISE

Neni 13

Organi vendimmarres i shoqerise "AUTO ÇOKU" SHPK eshte asambleja e ortakeve e perbere nga ortaku i vetem Z.Erlind Çoku. Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te ekspertëve kontabël te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë;
- i) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e pergjithshme merr vendime per cheshtjet e percaktuara ne shkronjat "e" dhe "ë" te pikës 1 te ketij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkatës. Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne një regjistër te vendimeve, te dhënat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Duhet regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Neni 14

Asambleja e pergjithshme mbledhet ne rastet e percaktuara nga ligji 9901, date 14.04.2008, nga ligje te tjera dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së pergjithshme thirret te paktën një here ne vit.

Asambleja e pergjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e percaktuar sipas nenit 84 te ketij ligji.

Asambleja e pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shesë apo te disponojë ne menyre tjetër aktive, te cilat kanë një vlerë më te lartë se 5 për qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Asambleja e pergjithshme thirret kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te blejë nga një ortak pasuri, qe kanë vlerë më te lartë se 5 për qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 deri ne 5 te ketij neni, asambleja e pergjithshme mund te miratojë një rezolutë keshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje per veprimtarinë e administratorëve.

MËNYRA E THIRRJES

Neni 15

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet një njoftimi me shkresë ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet te përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet te gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar per mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

KËRKESA NGA ORTAKËT E PAKICËS

Neni 16

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.

Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 14 të statutit.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

Neni 17

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

KUORUMI

Neni 18

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit 9901, date 14.04.2008, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

MARRJA E VENDIMEVE

Neni 19

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit për shoqëritë tregtare, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Neni 20

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverballi duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverballi i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverballi i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

ADMINISTRATORI

Neni 21

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar administrohet nga një ose disa persona fizike. Administratori i shoqërise emrohet me vendim të ortakut të shoqërise. Afati i qendrimit në detyrë të administratorit të shoqërise është për një periudhë 5 (pese) vjetecare.

Administrator i kësaj shoqërie është z. Erlind Çoku.

Administratori i shoqërise i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërise, në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që u njeh ligji shprehimisht Asamblese së Ortakëve ose të tremeve.

Administratori ka përgjegjësi ndaj shoqërise ose ndaj të tremeve për shkelje të ligjeve, statutit apo shkeljeve të kryera gjatë administratimit. Administratori në rastin konkret kryen dhe harton raportet financiare, llogarite vjetore etj.

RASTET E PUNES

Neni 22

Raportet e punës ndërmjet shoqërise, filialeve dhe agjensive të saj si dhe të punonjësve në të, rregullohen në bazë të kontratës së punës, konform Kodit të Punës.

Për sa nuk parashikohet në kontratën e punës, aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 23

Shoqëria merr përsipër, të shlyejë rregullisht të gjitha detyrimet e saj që burojnë nga legjislacioni për sigurimet shoqërore e shëndetësore lidhur me të punësuarit e saj.

PERFUNDIMI I AKTIVITETIT

Neni 24

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- 1.Me kalimin e afatit për kohezgjatjen e saj në kontratën e themelimit.
- 2.Për pamundësinë e realizimit të objektit të saj.
- 3.Me vendimin e gjykatës.
- 4.Me hapjen e procedurave të falimentit.

LIKUJDIMI

Neni 25

Likujdimi i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar do të bëhet sipas normave të legjislacionit shqiptar në fuqi në kohën e likujdimit.

KUSHTET E TJERA

Neni 26

Te gjitha vendimet e mara nga asambleja e ortakut te veten evidentohen ne nje liber te vecante, i cili administrohet ne seline e shoqerise.

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht dhe saktesisht ne kete, statut do ti referohen plotesimeve qe mund te beje ortaku i vetem si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Ky statut firmoset rregullisht

Per shoqerine tregtare **"AUTO ÇOKU" SHPK**

Ortaku i vetem

Erlind Çoku Elbasan, me 14/01/2025

